



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE  
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

## **Drafti i propozimit të politikave të ZRRUM-it për të mundësuar aktivitetet e PSP në sektorin e mbeturinave**

**Mars 2007**

---

### **1. PËRMBLEDHJE**

Ky draft-dokument mbi politikat përshkruan sfondin e rregullativës ekonomike të sektorit të mbeturinave në Kosovë dhe të bazave për presionit të rritur nga sektori privat dhe palëve tjera të interesit duke përfshirë UNMIK-un për të lejuar operatorët privat që të marrin pjesë plotësisht në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në të ardhmën e afërt.

Kohën e fundit, UNMIK-u dhe palët tjera kanë kërkuar nga ZRRUM-i të bëj ndryshime në legjislacionin për sa i përket rregullativës ekonomike me qëllim që ti të mundësohet sektorit privat në pjesëmarrja e tij në sektorin komunal të grumbullimit të mbeturinave në Kosovë. Politikat e qëndrueshme afatgjatë për menaxhimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në pajtim me praktikën e mire të vendeve tjera Europiane për sektorin është paraqitur në këtë propozim si parakusht i nevojshëm për zhvillimin e ndryshimeve të qëndrueshme legjislative.

**Pas konsultimeve të palëve të interesit mbi këtë draft të politikave të ZRRUM-it lidhur me PSP-së në sektorin e grumbullimit të mbeturinave, këto politika do të finalizoheshin dhe do të arrihej pajtimi për to, dhe më pastaj do të shërbenin për informimin dhe përforcimin e ndryshimeve të nevojshme të legjislacionit të reviduar lidhur me sektorin e mbeturinave, e përpiluar nga grupi punues i cili i raporton Komisionit të Tregtisë dhe Industrisë.**

Në këtë dokument janë të përfshira katër opsione të politikave:

1. Opcioni “Të mos ndërmerret asgjë” – Opcioni A
2. Marrëveshjet nënkontraktuese në mes të Ndërmarrjeve publike dhe operatorëve privat të grumbullimit të mbeturinave – Opcioni B
2. Opcioni tranzitor afatshkurtë-Opcioni C
3. Opcioni i qëndrueshëm afatgjatë-Opcioni D

**Opcioni i rekomanduar (politika e qëndrueshme afatgjate-opcionin D) përfshinë de-rregullimin e aktiviteteve të grumbullimit të mbeturinave komunale në**

**Kosovë sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që t'i lejoj operatorët privat të konkurrojnë haptas me Ndërmarrjet Publike ekzistuese në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave komunale në Kosovë. Njëkohësisht, Komunitat duhet të marrin përsipër përgjegjësinë për menaxhimin e sektorit për menaxhimin e mbeturinave përmes menaxhimit të prokurimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe përmes shpalljes së tenderit për shërbimet nga sektori privat dhe Ndërmarrjet Publike.**

**Ky opcion i propozuar konsiderohet të jetë i vetmi opcion i cili është:**

- **I qëndrueshëm dhe paraqet zgjidhje afatgjatë**
- **Në pajtim me praktikën e menaxhimit të mirë të mbeturinave në vendet e tjera Europiane;**
- **Në pajtim me objektivat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë me qëllim të shmangies së çrregullimeve në treg dhe minimizimit të rregullativës**
- **Nuk do të ketë ndikim të dëmshëm në grumbullimin e mbeturinave gjatë periudhës afatshkurte ose afatgjate në rast se janë menaxhuar në mënyrë të duhur**
- **Në pajtim me propozimet e Ahtisaarit<sup>1</sup> për Kosovën i cili do t'i jep fuqi të plotë komunave në sferat duke përfshirë “Sigurimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike duke përfshirë...menaxhimin e mbeturinave”**

Këto amendamente të propozuara të legjislacionit do të thejnë monopolin artificial të Ndërmarrjeve Publike në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe i obligon Komunitat të sigurojnë shërbimet përmes konkurrimit transparent dhe të hapur ndërmjet operatorëve të sektorit privat dhe Ndërmarrjeve Publike. Gjithashtu, komunitat duhet të jenë plotësisht përgjegjëse<sup>2</sup> për inkasimin ndaj konsumatorëve duke përfshirë konsumatorë shtëpiak dhe për pagesën e taksave të deponimit të mbeturinave ndaj KMDK/KLMC.

Ky opcion i rekomanduar mund të arrihet me sukses gjatë disa muajve të ardhshëm duke i ndërmarrë masat në vijim:

- **Caktimi i kohës së implementimit të ndryshimeve të propozuara legjislative dhe ndërmarrja e masave për ngritjen e kapaciteteve institucionale.**
- **Identifikimi i fondeve dhe Konsultantëve për ngritjen e kapaciteteve institucionale të Komunave duke përfshirë draftimin e modelit të kontratave për tenderimin konkurrues për shërbimet e mbeturinave<sup>3</sup>,**

---

<sup>1</sup> Neni 3 të Shtojcës III, pika 3.1 të dates Shkurt 2007

<sup>2</sup> Ky është rekomandim kryesor i draftit të strategjisë së mbulimit të shpenzimeve të EPTISA, të datës 31 Gusht 2006 për arritjen e mbulimit të plotë të shpenzimeve

<sup>3</sup> Modeli i dokumentit duhet të jetë relativisht i thjeshtë, kontratat 3-5 vjeçare në mes të ofruesit të shërbimeve dhe Komunës (ose grupeve të komunave) të bazuara në vëllimin e mbeturinave Komunale dhe standardave të caktuara minimale të shërbimit p.sh shpeshësia e grumbullimit, etj.

trajtime të prokurimit dhe përkrahjen e zhvillimit të Ligjit mbi Mbeturina “Aktet Nënligjore”

- Zëvendësimi i Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 mbi rregullatorin ekonomik (*Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit, Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave*) me rishikimin e draftit të (2004) Ligji<sup>4</sup> mbi ZRRUM-in (*Draft-Ligji mbi rregullatorin ekonomik të Kompanive të Ujit dhe Mbeturinave*) duke përfshirë disa amendamente të rëndësishme të disa neneve lidhur me de-rregullimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për të ndihmuar PSP-në. Ky aktivitet është në zhvillim e sipër nga ana e grupit të vogël punues (përfshirë Drejtorin e ZRRUM-it). Grupi punues e raporton te Komisioni për Ekonomi Tregëti dhe dhe Industri i Kuvendit të Kosovë.
- Revizioni i Ligjit aktual mbi Mbeturina (Rregullore e UNMIK-ut 2006/31) me mënjanimin e kundërshtimeve aktuale në Rregulloren 2004/49 lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e ZRRUM-it, rregullativën ekonomike. (Nuk është e qartë nëse grupet e ndara punuese do të jenë përgjegjëse për revizionin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/31). Gjithashtu paraqitja e pikës së re në Ligjin e reviduar Mbi Mbeturinat (në harmoni me ndryshimet e propozuara në këtë dokument), që i obligon Komunitat (ose grupet e Komunave) që të hapin tenderat për sigurimin e grumbullimit të mbeturinave komunale përmes procedurave të hapura dhe transparente të tenderit deri kah mesi i vitit 2008 që do të jenë të nënshtruara auditimit nga organet lokale.
- Të sigurohet se Komunitat do të jenë në pozitë që në afat të shkurtër të marrin përgjegjësi të plotë për menaxhimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave përmes procesit të tenderimit të hapur. (Përkrahja Institucionale nga donatorët do të jetë e nevojshme për të siguruar që Komunitat të kenë kapacitet që të kryejnë përgjegjësitë e tyre në pajtim me Ligjin origjinal Mbi Mbeturinat)
- ZRRUM-i duhet t'i përcaktoj tarifat për 2008 (që duhet të përfundohen deri me 1 Tetor 2007) dhe pas kësaj duhet të ketë rolin e kufizuar në monitorimin e performancës të sektorit të grumbullimit të mbeturinave gjatë periudhës fikse (p.sh. deri në Prill 2008) për të siguruar që Komunitat të kenë kontrollin e përgjithshëm mbi sektorin.

## 2. SFONDI

### *Korniza ligjore*

Rregullorja aktuale e UNMIK-ut 2004/49 (*Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Ujërave të Zeza dhe të Mbeturinave*) nxjerr përgjegjësitë e Rregullatorit ekonomik për shërbimet e ujit dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë (ZRRUM). Fushëveprimi i kësaj Rregulloreje (përfshirë lëshimin e licencave të shërbimit nga ZRRUM-i për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave) në formën e tashme të saj zbatohet vetëm për Ndërmarrjet Publike (NP) dhe Ndërmarrjet Shoqërore (NSH). Prandaj nuk është e mundur për ZRRUM-in që thjeshtë të

---

<sup>4</sup> Draft-Ligji (Neni 2 (a)) njeh përparësitë e pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave lidhur me investimet dhe ekspertizën menaxhuese

lëshojë licenca operatorëve privat të grumbullimit të mbeturinave (ose operatorëve të deponimit) nën legjislacionin aktual.

Draft-Ligji mbi Regullatorin Ekonomik të Ujit, Ujërave të Zeza, Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta dhe Kompanive të Deponimit të Mbeturinave të Ngurta në Kosovë (tani e tutje "Draft-Ligji i ZRRUM-it) është përpiluar në vitin 2004 por nuk është aprovuar nga Kuvendi pasi që rregullativa ekonomike ishte fuqi e rezervuar për UNMIK-ut. Ky draft-Ligj i ZRRUM-it e njeh (parasheh) rolin e sektorit privat në Nenin 2-Pika (a).

#### *Aktivitetet e operatorëve privat në Kosovë*

Kohën e fundit, operatorët privat janë bërë aktiv në shkallë të gjerë në sektorët profitabil, komercial dhe industrial të grumbullimit të mbeturinave (p.sh. në sigurimin i shërbimeve të grumbullimit ndaj UNMIK-ut dhe supermarketeve) dhe kanë qenë aktiv në lobimin e UNMIK-ut, MMPH, Odës Ekonomike të Kosovës dhe ZRRUM-it që të licencohen<sup>5</sup> për t'i ofruar këto shërbime të grumbullimit në mënyrë ligjore dhe mundësisht t'i zgjerojnë ato në zona tjera p.sh. grumbullimi komunal shtëpiak.

Si masë afatshkurtë, modeli i marrëveshjeve nënkontraktuese ka qenë i zhvilluar nga ZRRUM-i në bashkëpunim me Ndërmarrjet Publike dhe palët e tjera me qëllim që t'i ndihmoj sektorit privat pjesëmarrjen si nënkontraktues në Ndërmarrjet Publike derisa të zhvillohet një politikë afatgjate mbi PSP (Pjesëmarrjen e Sektorit Privat).

#### *Aktivitetet e grumbullimit të mbeturinave komunale*

Nuk ka indikacione që do të dëshmonin se sektori privat është i interesuar në pjesëmarrjen në aktivitetet (momentalisht joprofitabile) të grumbullimit të mbeturinave komunale dhe shtëpiake. Këto aktivitete karakterizohen me shkallën e ulët të inkasimit dhe tarifat e ulëta dhe janë të kufizuara në çështjet e aftësisë paguese (mundësisë)<sup>6</sup>. NP aktualisht nuk janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet e tyre operative dhe të mirëmbajtjes dhe varen nga donatorët për sigurimin e pajisjeve si dhe nga subvencionet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për të kompenzuar deficitin (mungesën)<sup>7</sup> e të ardhurave vjetore.

Ndryshe nga vendet e tjera Europiane, Ndërmarrjet publike të grumbullimit të mbeturinave janë direkt përgjegjëse për inkasimin e mjeteve nga konsumatorët duke përfshirë konsumatorët shtëpiak dhe kanë efikasitet të inkasimit të vetëm rreth 50% ose më pak, përkundër shpenzimeve për këtë aktivitet që përbëjnë rreth 10 % të shpenzimeve të përgjithshme operative. Në shumicën e vendeve Europiane, ky aktivitet është përgjegjësi e Komunës e cila ka fuqi ligjore të bëjë inkasimin ndaj konsumatorëve dhe si rrjedhojë e kësaj mund të arrij shkallë më të lartë të inkasimit.

---

<sup>5</sup> See IPA report on Affordability and willingness to pay-desk study dated March 2007 produced as a deliverable under the EAR funded EERO Institutional Support Project. Shiko raportin e IPA mbo Mundësinë dhe gatishmërinë për të paguar-parastudim i datës Mars 2007

<sup>6</sup> See IPA report on Affordability and willingness to pay-desk study dated March 2007 produced as a deliverable under the EAR funded EERO Institutional Support Project.

<sup>7</sup> See IPA report on Affordability and willingness to pay-desk study dated March 2007 produced as a deliverable under the EAR funded EERO Institutional Support Project.

### *Qëndrimi i Palëve të Interesit për PSP*

UNMIK-u ka kërkuar nga ZRRUM-i t'i formuloj amendamentet të legjislacionit aktual lidhur me rregullativën ekonomike (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49) me qëllim që ta lejojë sektorin privat që të operojë në mënyrë ligjore në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. UNMIK-u ka propozuar një opcion tranzicional që mund të implementohet shpejtë me amendamentimin e legjislacionit aktual të mbeturinave me qëllim të adresimit të problemeve aktuale lidhur me mungesën e qasjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave por pa paraqitur ndonjë opcion tjetër afatgjatë d.m.th masat e qëndrueshme.

Eshtë e kuptueshme që AKM-a është kundër futjes së PSP-së në sektorin e mbeturinave përderisa të arrihet që Ndërmarrjet Publike të janë të inkorporuara dhe mjaft të forta që të konkurrojnë për ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave me sektorin privat. Aktualisht NP janë të konsoliduara<sup>9</sup> në ndërmarrje regjionale (në teori nëse jo në praktikë) por nuk janë të inkorporuara<sup>10</sup> ende.

Ekzistojnë çështjet e rëndësishme të pazgjidhura lidhur me pronësinë e kompanive të inkorporuara të NP.

### *Grupi Punues*

Aktualisht grupi punues i cili përbëhet nga përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës, UNMIK-ut dhe ZRRUM-it janë duke punuar në amendamentimin e draft-Ligjit<sup>8</sup> të ZRRUM-it do të përfshijnë amendamentet duke lejuar aktivitetet e PSP në sektorin e mbeturinave si dhe të Bordit kolegjial dhe amendamentet e tjera të nevojshme. Ky grup punues do të përgatisë draftin e Ligjit për Rregullativën Ekonomike që do të diskutohet në grupin punues në kuadër të Komisionit për Tregti dhe Industri të Kuvendit të Kosovës.

### *Deponimi i Mbeturinave*

Aktualisht sektori privat është i përfshirë në sektorin e deponimit të mbeturinave në nivel të kufizuar si nënkontraktues që i operon katër deponi të financuara nga AER në Kosovë. Këta nënkontraktues nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK/KLMC). KMDK/KLMC është Ndërmarrje e Inkorporuar Publike, e rregulluar nga ZRRUM-i lidhur me përcaktimin e tarifave dhe lëshimin e licencave të shërbimit dhe nga MMPH lidhur me aspektet rregullativës së mjedisit. KMDK/KLMC është ofrues i shërbimeve në kushte të monopolit. Ka mundësi që ky aktivitet të privatizohet në të ardhmën ose të këtë ndonjë formë tjetër të PSP të zbatohet, por kjo nuk konsiderohet si e përshtatshme tash për tash.

Aktualisht, nga ndërmarrjet e grumbullimit të mbeturinave (NP) pritet që të paguajnë për shpenzimet e deponimit të mbeturinave komunale në deponi të licencuar dhe të menaxhuar nga KMDK/KLMC dhe t'i mbulojë tarifat e deponimit të caktuara nga

---

<sup>8</sup> See IPA report on Affordability and willingness to pay-desk study dated March 2007 produced as a deliverable under the EAR funded EERO Institutional Support Project.

KMDK/KLMC përmes pagesave të konsumatorëve. Në praktikë, si rezultat i efikasitetit të ulët të inkasimit veçanërisht në sektorin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake, Ndërmarrjet Publike, normalisht, nuk i paguajnë KMDK-së çmimet e plota për deponim<sup>9</sup> dhe KMDK-a merr subvencione vjetore përmes AKM-së nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Kjo nuk është në pajtim me praktikën e mirë të vendeve tjera dhe një alternative tjetër do të duhej gjetur.

### **3. DRAFT POLITIKA E ZRRUM-it MBI MENAXHIMIN E MBETURINAVE PËRFSHIRË PSP-në**

*Mungesa aktuale e politikave*

**Aktualisht nuk ka politika formale të qeverisë mbi ‘menaxhimin e mbeturinave’ në Kosovë.** Disa çështje të politikave mund të nxirren nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 dhe Ligji origjinal mbi Mbeturina, që është dekretuar me Rregullorën e UNMIK-ut 2006/31 (p.sh. roli qendror për Komunitat në zhvillimin e planeve të menaxhimit të mbeturinave). Megjithatë, teksti shtesë me të cilin është dekretuar Ligji për Mbeturina<sup>11</sup> nga UNMIK është në kundërshtim me disa nga parimet kryesore siç është cekur në Ligjin origjinal të Mbeturinave dhe riafirmon rolin e ZRRUM-it si rregullator ekonomik.

UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës, në përgjithësi mbështesin aktivitetet e PSP-së në sektorin e grumbullimit të mbeturinave. Megjithatë, aktualisht nuk ka politika specifike të publikuara nga Qeveria e Kosovës ose UNMIK-u në të cilat është i bazuar legjislacioni primar lidhur me sektorin e mbeturinave (p.sh. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/31 dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49)

Shënim: Është e njohur përgjithësisht se roli kryesor i rregullatorëve të shërbimeve publike është *implementimi i politikave (jo zhvillimi i tyre)* edhe pse nuk ka asgjë të keqe që rregullatorët të rekomandojnë ndryshimet e politikave ku shihet që është e nevojshme.

Gjithashtu, në përgjithësi dihet se legjislacioni duhet të bazohet në politikat e pajtuara nga sektori ashtu siq hartohen nga Qeveria.

Me qëllim të lehtësimit të ndryshimeve në legjislacionit për lejimin e sektorit privat të marr pjesë në aspektet relevante të grumbullimit të mbeturinave në Kosovë, në këtë dokument është e nevojshme që të paraqitet drafti i politikave i cili përfshinë rolin e sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave në Kosovë.

*Draft-politikat e ZRRUM-it*

Draft i politikave të ZRRUM-it mbi PSP është i propozuar më poshtë dhe duhet të diskutohet me palët e tjera duke përfshirë Qeverinë e Kosovës dhe përfaqësuesit e operatorëve privat. Pasi që këto politika të jenë finalizuar duhet të shërbejnë për informimin dhe përforcimin e zhvillimit të legjislacionit të reviduar (në bazë të draft-ligjit aktual të ZRRUM-it) duke përfshirë rolin e sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave si dhe ndryshimet e tjera të nevojshme (përfshirë Bordin e ZRRUM, etj.)

---

<sup>9</sup> See IPA report on Affordability and willingness to pay-desk study dated March 2007 produced as a deliverable under the EAR funded EËRO Institutional Support Project.

Parimet kryesore të politikave të propozuara nga ZRRUM-i lidhur me rolin e ardhshëm të PSP në sektorin e mbeturinave (përfshirë aktivitetet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave) janë cekur më poshtë. Është e njohur se sektori privat është i interesuar vetëm në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në ato raste ku është komercialisht profitabile. Sektori privat është më pak i interesuar që të konkurroj për komponentet më pak profitabile të grumbullimit të mbeturinave Komunale (p.sh. mbeturinat shtëpiake) sidomos në planin afatshkurtër. Sidoqoftë, nuk konsiderohet e përshtatshme që të kufizohet fushëveprimi i PSP vetëm në komponentat profitabile të grumbullimit të mbeturinave. (p.sh. grumbullimi nga Konsumatorët Industrial, Komercial, dhe Institucional që prodhojnë shkallë të mesme-madhe të vëllimit të mbeturinave të ngurta Komunale). **Në të vërtetë, largimi i komponentave më profitabile nga obligimet aktuale të ND në ofrimin e shërbimeve (sipas Opcionit C) mund të shpie te kërkimi i më shumë subvencioneve si rezultat i humbjes së subvencionit nga këto aktivitete që janë më profitabile.**

#### 4. PËRMBLEDHJA E OPCIONEVE TË POLITIKAVE

##### *Hyrje*

Ekzistojnë katër opsione kryesore të politikave për menaxhimin e sektorit të mbeturinave në Kosovë:

1. Opcioni “Të mos ndërmerret asgjë”-Opcioni A
2. Marrëveshjet nënkontraktuese në mes të Ndërmarrjeve Publike dhe operatorëve privat-Opcioni B
3. Opcioni trazitor afatshkurtër-Opcioni C
4. Opcioni i qëndrueshëm afatgjatë-Opcioni D

Këto opsione janë paraqitur në vijim:

##### *Opcioni A-“Të mos ndërmerret Asgjë”*

Opcioni “Të mos ndërmerret asgjë” (Opcioni A) nuk konsiderohet të jetë i përshtatshëm duke pasë parasysh nevojën që të jipet përgjigje shqetësimeve të palëve të interesit lidhur me PSP-në siç është përshkruar më lartë.

##### *Opcioni B- Marrëveshjet nënkontraktuese në mes të NP dhe operatorëve privat*

Iniciativa e ZRRUM-it që të zhvilloj modelin e marrëveshjeve nënkontraktuese me qëllim që të lejoj sektorin privat të ofrojë shërbimet si nënkontraktues i NP, ka qenë zgjidhje e përkohëshme dhe e arsyeshme por nuk konsiderohet si zgjidhje e qëndrueshme afatgjatë dhe kështu që nuk mirret më parasysh. As ND dhe as sektori privat nuk e sheh këtë Opcion si të arsyeshëm.

##### *Opcioni C- Opcioni tranzicional afatshkurt*

Opcioni tranzicional afatshkurt (Opcioni C) është favorizuar nga disa prej palëve duke përfshirë UNMIK-un si “zgjidhje e shpejtë” në adresimin e nevojave për të

mundësuar në njëfarë mënyre rolin e kufizuar në sferat më profitabile të grumbullimit të mbeturinave (praktikisht kjo do të nënkuptonte legalizimin e gjendjes aktuale ku operatorët privat ofrojnë shërbime për konsumatorët e mëdhenj profitabil). Ky opcion nuk rekomandohet por është trajtuar më poshtë:

#### Përparësitë e opcionit C

- Ky opcion mund të legjitimoj aktivitetet aktuale të PSP-së duke i lejuar ZRRUM-i të licencoj operatorët privat për të konkurruar me NP për grumbullimin e mbeturinave për konsumatorë të caktuar të shkallës së mesme-të kategorisë industriale, komerciale, dhe institucionale në një mjedis të derregulluar përderisa NP do të vazhdonin ofrimin e shërbimeve në formë monopoli të rregulluar por artificial për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave komunale shtëpiake (të amvisnive).

#### Mangësitë e opcionit C

- Masat tranzitore afatshkurta zakonisht shndërrohen në masa afatgjata joadekuate. Nëse kjo do të ndodhte, atëherë mundësia e revizionit të legjislacionit për të siguruar zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë do të rezultonte me disa vite të humbura.

- NP të cilat do të vazhdonin me grumbullimin mbeturinave komunale shtëpiake do të kërkonin **subvencione më të mëdha** nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të kompenzuar humbjen e konsumatorëve profitabil të mëdhenj.

- Do të kishte fare pak motivim për NP që të bëhen komercialisht të fokusuar dhe ato ende do të kërkonin rregullim ekonomik (psh. vendosja e tarifave dhe monitorimi i standardeve të shërbimit nga ZRRUM-i)

- Sektori i grumbullimit të mbeturinave, pjesërisht i derregulluar mund të paraqes probleme të mëdha për rregullimin konsistent nga ZRRUM-i, rregullatorit ekonomik.

- Sipas Ligjit origjinal mbi Mbeturinat, komunave do t'iu mohohej përgjegjësia e përgjithshme për menaxhimin e ofrimit të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.

- Ky opcion do ta përkrahte monopolin artificial mbi ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave shtëpiake. **Kjo nuk është në pajtim me praktikën e mirë të shumicës së vendeve Europiane ose me politikën e Qeverisë së Kosovës mbi eliminimin pengesave në treg dhe minimizimin e rregullativës së panevojshme.**

#### *Opcioni D-opcioni i qëndrueshëm afatgjatë*

Opcioni i qëndrueshëm afatgjatë-Opcioni D favorizohet nga ZRRUM-i. Ky opcion është trajtuar më poshtë:

#### Përparësitë e Opcionit D

- Ai do të siguronte një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë në pajtim me praktikën e mirë të vendeve tjera Europiane dhe do t'i eliminonte obligimin e ZRRUM-i që të rregullojë monopolin artificial siq është ofrimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave.

- Do të mundësonte PSP në të gjithë sektorin e grumbullimit të mbeturinave duke përfshi ekonominë e shkallës të cilat do të tërhiqnin investimet e

rëndësishme dhe poashtu ekspertizën menaxhuese për sektorin e grumbullimit të mbeturinave.

- Do të mundësonte që Komunitat të marrin përgjegjësinë e plotë në menaxhimin e sektorit të grumbullimit të mbeturinave në zonat e tyre të shërbimit duke përfshirë prokurimin e shërbimeve.

- Nuk pritet që zgjidhja e propozuar afatgjatë të shkaktojë ndonjë çrregullim në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave me kusht që tranzicioni të menaxhohet në mënyrë të duhur dhe që ZRRUM-i të jetë përgjegjës sipas legjislacionit të reviduar për caktimin e tarifave për 2008 (që duhet të përfundohet kah 1 Tetori 2007) dhe për monitorimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në periudhën e kufizuar (maksimum 12 muaj) psh. deri në Prill 2008 përderisa Komunitat do të jenë të gatshme për marrjen nën kontroll të sektorit.

#### Mangësitë e opcionit D

- Do të nevojiten aktivitete shtesë në afat të shkurtë për zbatimin e ndryshimeve të nevojshme legjislative.

- Do të nevojitet përkrahja institucionale për t'i ndihmuar Komunitat në marrjen e përgjegjësisë plotësuese të menaxhimit të sektorit të grumbullimit të mbeturinave duke përfshirë prokurimin e këtyre shërbimeve përmes tenderit të hapur.

- Ndërmarrjet Publike mund të mos jenë në gjendje të konkurrojnë me sektorin privat dhe mund të zhduken (edhe pse resurset njerëzore të afta mund të kalojnë te operatorët e sektorit privat dhe të sigurojnë aftësitë e nevojshme menaxhuese dhe operative).

## **5. DETAJET E OPCIONEVE**

### **5.1 Opcioni C. Opcioni afatshkurt i politikës<sup>10</sup>**

Opcioni afatshkurt i politikës për menaxhimin e sektorit menaxhues të mbeturinave (shërbimet e grumbullimit dhe deponimit) **nuk është opcion i rekomanduar nga ZRRUM-t dhe nuk mirret parasysh më.**

### **5.2 Opcioni D. Opcioni i Qëndrueshëm Afatgjatë i Politikës**

Opcioni afatgjatë i politikave për menaxhimin e sektorit të mbeturinave (shërbimet e grumbullimit dhe të deponimit) është paraqitur më poshtë. **Ky është opcion i rekomanduar nga ZRRUM-i:**

*Aktivitetet e grumbullimit të mbeturinave në Kosovë*

Aspektet kryesore të opcionit të qëndrueshëm afatgjatë të politikës janë:

---

<sup>10</sup> Psh. për periudhën 2007-2009 të lejohet që NP të jenë të konsoliduara dhe të inkorporuara tërësisht dhe që Ligji aktual mbi Mbeturina, i nxjerr nga UNMIK-u sipas 2006-02 të implementohet (përfshirë zhvillimin e akteve nënligjore) dhe që të gjitha detyrat rregullative për menaxhimin e mbeturinave të jenë nën përgjegjësinë e Komunitave (ose grupeve të Komunitave) ose MMPH dhe që ZRRUM-i të mos të ketë rolin e rregullatorit ekonomik të sektorit të grumbullimit të mbeturinave.

- Inkorporimi i NP gjatë disa muajve të ardhshëm (me përfitimet e parashikuara në performancën e përmirësuar financiare që të sigurojë konkurrimin e drejtë e NP me sektorin privat për ofrimin e shërbimeve të aktiviteteve të grumbullimit të mbeturinave komunale<sup>11</sup>)
- De-rregullimi i sektorit të përgjithshëm të grumbullimit të mbeturinave të ngurta përmes zbatimit të Ligjit të ndryshuar të ZRRUM-it si pjesë e rishikimit aktual legjislativ në të cilin roli i ZRRUM-it është i kufizuar si rregullator ekonomik vetëm të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, shërbimeve të ujit me shumicë, si dhe shërbimeve të deponimit të mbeturinave komunale.

Pasiqë komunat të jenë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave sipas Ligjit origjinal për Mbeturinat atëherë ato do të jenë tërësisht përgjegjëse për prokurimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave përmes tenderit të hapur për periudhën prej 3-5 vite dhe do të jenë përgjegjëse për zhvillimin e planeve lokale të menaxhimit të mbeturinave dhe vendosjen dhe monitorimin e standardeve të performancës në pajtim me praktikën e mirë të vendeve tjera Europiane. NP duhet të jenë në gjendje të konkurrojnë<sup>13</sup> në baza të barabarta me sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve.

#### Aktivite e deponimit të mbeturinave

Në afat të gjatë, ekzistojnë mundësi që secila deponi të privatizohet sipas standardeve të përgjithshme të vendosura nga rregullatori qendror i mjedisit, MMPH, dhe që secila prej tyre të konkurroj për shërbimet e deponimit të mbeturinave në Kosovë. Në praktikë shpenzimet fikse do të jenë të ngjajshme për të gjitha lokacionet e deponive dhe tarifat e transportit do të përcaktojnë cilat deponi janë përdorë nga kompanitë e grumbullimit. Për disa vite të ardhshme, situata aktuale ku KMDK/KLMC menaxhon operimin e katër deponive përmes kontratave të tenderit me afat 3-vjeçar me nënkontraktues privat do të duhej të vazhdonte.

## 6. AKRONIMET

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
TER	Termat e Referencës
ZRRUM	Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina
PSP	Pjesëmarrja e Sektorit Privat
KDMK/KLMC	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
NP	Ndërmarrjet Publike
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

<sup>11</sup> Supozohet sipas strategjisë së mbulimit të shpenzimeve të EPTISA të jetë gjatë vitit 2010